

VENDIM
Nr.613, datë 21.12.1999

PËR NJË SHITESË NË FONDET BUXHETORE TË VITIT 1999

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 21, të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit në republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Aparatit të Këshillit të Ministrave, në buxhetin e miratuar për vitin 1999, në zërin “shpenzime operative”, i shtohen 20 milionë lekë, për pagesën që Grupi i Mbikëqyrjes së kontrollit dhe administrimit të shoqërive huamarrëse duhet të bëjë kundrejt kontratave me shoqëritë audituese.

2.Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3.Ngarkohen aparati i Këshillit të Ministrave dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta